



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1452/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Raiffeisen Bank Kosovo JSC me seli në Prishtinë rr. UQK nr.51 kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditues të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.93/2015 të datës 26.04.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.07.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.93/2015 të datës 26.04.2022, Prishtet, dhe Lënda i kthehet Gjykatës Komerciale – Dhomave të Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, në pikën I të dispozitivit ka vendosur: Aprovohet Pjesërisht si e bazuar Kërkesëpadia e paditësit Raiffeisen Bank Kosovo JSC me seli në Prishtinë, nën pikën II. Anulohet vendimi nr.446/2014 i datës 18.12.2014 i Administratës Tatimore të Kosovës-Departamenti i Ankesave, nën pikën III. Obligohet e paditura Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, që paditësit Raiffeisen Bank Kosovo JSC me seli në Prishtinë, t,ia kthej shumën prej 937,077.51€, të paguar nga paditësi, si rezultat i mos njohjes se shpenzimeve të këmbimeve ndërvalutore (sëap transaksioneve) si shpenzime të zbritshme në pasqyrën e të ardhurave për vitin 2008 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, me kamatë ligjore në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga paditësi dhe datën kur e paditura e referon për pagesë –rimbursim Ministrisë së Financave, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën pikën IV. Refuzohet si e pabazuar pjesa tjetër e kërkespadiës së paditësit Raiffeisen Bank Kosovo JSC me seli në Prishtinë, përtej shumës së gjykuar si në dispozitivin III të këtij aktgjykimi, për kthimin edhe të shumës në vlerë prej 54,528.09€ si rezultat i mos njohjes se shpenzimeve të këmbimeve ndërvalutore (sëap

transaksioneve) si shpenzime të zbritshme në pasqyrën e të ardhurave për vitin 2008 për Tatimin në të Ardhura të Korporatave, nën pikën V Ky aktgjykim e zëvendëson vendimin nr.446/2014 i datës 18.12.2014 i Administratës Tatimore të Kosovës- Departamenti i Ankesave, nën pikën VI Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar e paditura me të cilin e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të; shkeljes së dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e Administratës Tatimore të Kosovës si e bazuar, Anulohet pjesërisht aktgjykimin i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.93/15 dt.31.05.2022 lidhur me paditësin Raiffeisen Bank Kosovo JSC me seli në Prishtinë, të Mbetet në fuqi vendimi nr.446/2014 i datës 18.12.2014 i Administratës Tatimore të Kosovës-Departamenti i Ankesave.

Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar, si në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenit 49 i LKA-së, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me aktvendimin nr. 446/2014 dt.18.12.2014, e ka Refuzuar si të pabazuar ankesën e tatimpaguesit Raiffeisen Bank Kosovo JSC me seli në Prishtinë, në mbështetje të nenit 136/a të Ligjit 02L-28 për Procedurën Administrative, në lidhje me par.2 të nenit 89 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, dhe Njoftim Rivlersimet e tatimit shtesë për TAK për vitin 2008 vërtetohen si të bazuara.

Paditësi, i pa kënaqur me vendimin e lartcekur ka ushtruar padi në konflikt administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me të cilën e konteston ligjshmërinë e vendimit të saj dhe kërkon që i njëjti të anulohet si jo ligjor.

Gjykata e shkallës së parë, në rigjykim, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit të lart cekur, vërejtjeve të dhena me aktvendimin A.nr.746/19 dt.19.03.2021 i Gjykatës së Apelit, dëgjimit të dëshmitarit-inspektorit tatimor, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor datës 26.04.2022, e duke u bazuar edhe ekspertizën financiare dhe plotësim ekspertizat financiare, bie Aktgjykimin e ankimuar me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit, jepen vlersimet faktike dhe juridike të gjykatës, se e paditura në kundërshtim me legjislacionin tatimor nuk i ka njohur paditësit shpenzimet e këmbimit ndërvalutor të njohura si “Swap transaksione” si shpenzime të zbritshme për TAK për vitin 2008 sipas deklaratës korrigjuese të paditësit për TAK për vitin 2008. Gjykata i fali besimin ekspertizës dhe plotësimin të ekspertizave që janë në harmoni me shkresat e lëndës dhe legjislacionin tatimor, as në nenin 7 dhe as në nenin 8 të Rregullores 2004/51 mbi TAK nuk ka përkufizime se këmbimet ndërvalutore nuk mund të pranohen si shpenzime të zbritshme. E paditura i ka njohur paditësit shpenzimet e këmbimeve ndërvalutore për

vitin 2006 dhe 2007. Gjykata referohet ne dispozitat e nenit 7 të Rregullores 2004/51 mbi TAK, nenin 3 të UA 01/2005 mbi Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/51 per TAK.

Dhomat e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes dhe duke shqyrtuar vendimet e organit të paditur, aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë, vërejtjet e dhëna nga Gjykata e Apelit, si dhe shkresat e tjera të lëndës, gjen se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. (n), neni 183, dhe zbatim i gabuar i të drejtës materiale nga neni 184 i LPK-së.

Kolegji, i Dhomave të Shkallës së Dytë, shqyrtoi me kujdes shkresat e lëndës, dhe erdhi në përfundim se përkundrejt fakteve se Gjykata e Apelit ne aktvendimin A.746/19 dt.19.03.2021, përveq vërejtjeve tjera ka kërkuar nga gjykata e shkallës së parë, në rigjykim, ti mënjanon të metat që kanë të bëjnë me çështjen kryesore te tatimit shtesë të caktuara nga kontrolli, përkitazi me mos pranimin e shpenzimeve të këmbimit ndërvalutor per vitin 2008, nga kontratat SWAP, të lidhura mes paditësit me Raiffeisen Bank Zentral Bank Oestereich.

Kolegji vlersoi, se në rigjykim, gjykata e shkallës së parë, nuk ka vërtetuar në plotni gjendjen faktike, kur pranon të zbritshme shpenzimet e këmbimit ndërvalutor për Tatimin në të Ardhurat e Korporatve për vitin fiskal 2008, në bazë të faktit se të njëjtit subjekt i janë pranuar këto shpenzime në periudhen 2006, 2007, janë dokumentuar pagesat bankare të realizuara sipas kontratave, se këto shpenzime kanë ndodhur, dhe se nuk ka përkufime ligjore se këmbimet ndërvalure (SWAP transaksionet) nuk mund të pranohen si shpenzime të zbritshme.

Kjo gjendje faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, bie ndesh me dispozitën ligjore nga neni 183 të LPK-së, me të cilën përcaktohet se: *ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare.*

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike nga dokumentacioni i lëndës, është dashur ta vërtetoj mbi bazën ligjore të cilën e ka zbatuar në këtë rast e paditura, Ligji nr.2004/48 dhe Rregullorja 2004/51, Udhëzimi Administrativ nr.01/2005 për zbatimin e Rregullores 2004/51 per Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, ku si bazë referuese është dashur të merret edhe përgjigja me shkrim e dhënë nga Banka Qëndrore e Kosovës, sa i përket vlersimit të instrumenteve financiare Swap, pastaj dokumentimi i shpenzimeve swap të kontratave, ku e paditura ka mohuar të jep përgjigje kontrollit sa i përket ndodhjes së shpenzimeve me degën amë në Austri.

Kolegji i Dhomave të shkallës së dytë, vlersoi se gjykata e shkallës së parë jep konstatime kontradiktore lidhur me ekzistimin e bazës ligjore për lejimin e shpenzimeve të këmbimeve ndërvalutore swap kontratave. Përderisa në arsyetim të aktgjykimit vihet në dilem përcaktimi i qart ligjor përkitazi me njohjen e shpenzimeve të swap transaksioneve, në anën tjetër gjykata e shkallës së parë vendimin e mbështet në atë se çështja e njohjes së shpenzimeve të lejueshme për qëllime tatimore është qështje e cila hyn në fushveprimin e legjislacionit tatimor të aplikueshëm, duke u referuar ne nenin 7 të Rregullores 2004/51 mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave dhe nenin 3 të Udhëzimit Administrativ 01/2005 mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/51 mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave. Prandaj si i tillë, Kolegji vlersoi se aktgjykimi ankimor përfshin një sërë

shkeljesh esenciale të dispozitave të nenit 182 par.(n) të LPK-së, dhe për shkak se nuk është sqaruar në tërësi gjendja faktike ku si rezultat i saj është zbatuar gabimisht edhe e drejta materiale nga neni 184 të LPK-së, ku përcaktohet se: *Zbatimi i gabueshëm i së drejtës materiale ekziston kur gjykata nuk e ka zbatuar dispozitën e së drejtës materiale që është dashur ta zbatojë, apo kur dispozitën e tillë nuk e ka zbatuar në mënyrë të drejtë.*

Për arsyet e dhëna më lartë, aktgjykimi i kundërshtuar është dashur të priset, dhe qështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, për ti mënjeluar shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi (n), neni 183, 184 të LPK-së, që janë të atilla që pengojnë vlersimin e ligjshmëris së aktgjykimit të goditur.

Në ri procedure, Dhomat e shkallës së parë, duhet ti shqyrtojë të gjitha vërejtjet e dhëna nga Kolegji i kësaj gjykate, të shqyrtoj me kujdes dispozitat e legjislacionit tatimor, si dhe provat që janë nxjerr gjatë procedurës administrative, ashtu që me rastin e vendim marrjes, ku e paditura ka kontestuar lejmin e shpenzimeve të këmbimit ndërvalutor të swap kontratave, për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave per vitin fiskal 2008, të vërtetohen provat që ka ofruar paditësi në drejtim të dokumentimit të shpenzimeve të transaksioneve swap, të realizuara në raport me degën e saj Raiffeisen Zentral Bank në Austri, gjithnjë duke u bazuar në legjislacionin tatimor.

Dhomat e shkallës së parë sipas nevojës dhe kërkesave të palëve ndërgjyqëse, të siguroj prova nga palët e treta, apo edhe përmes ekspertizës në lëmin përkatëse, me qëllim të konstatimit të saktë të gjendjes faktike. .

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, lidhur me nenin 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1452/22 me datë 20.07.2023

Kryetar i kolegjit,
Krenar Berisha